EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8440
E enjte, 26 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Rreth 39 për qind e energjisë elektrike në veri nuk është faturuar gjatë vitit 2025 FAQE 8



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KOSOVA RREZIKON HUMBJE PËRTEJ SPORTIT NËSE S'I ORGANIZON LOJËRAT MESDHETARE FAQE 4-5



Kosova rrezikon të humbë të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare 2030 për shkak të mospajtimeve institucionale ndër të tjera. Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare do ta shqyrtojë situatën në Kosovë në mbledhjen e 19 dhjetorit. Sipas ekspertëve, humbja e së drejtës së organizimit do ta dëmtonte imazhin ndërkombëtar të Kosovës, do ta privonte ekonominë nga mundësitë për përfitime dhe do t'i rrezikonte investimet e planifikuara në infrastrukturë

AKTUALE



SAMITI I ZGJERIMIT NË BRUKSEL. BE-ja DHE BALLKANI PERËNDIMOR DISKUTOJNË INTEGRIMIN, REFORMAT DHE SIGURINË E RAJONIT F. 2

KURTI PARALAJMËRON PROGRAMIN E RI QEVERISËS: JAVËN E ARDHSHME PUBLIKOHET DRAFTI F. 3

RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS KËRKON QË FEMICIDI TË NJIHET SI VEPËR E VEÇANTË PENALE F. 6

EKONOMI



BQK-ja MIRATON TRI UDHËZIME PËR ZBATIMIN GRADUAL TË BANKIMIT TË HAPUR NË KOSOVË F. 8

SPORT



DELEGACIONI I UEFA-s NË KOSOVË, ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË FUTBOLLIT NË FOKUS TË VIZITËS F. 11

SHQETËSIMET PËR GJYKATËN SPECIALE DHE KËNGËN NACIONALISTE NË BRUKSEL DISKUTOHEN ME AMBASADORIN E BE-së F. 3



MBAHET TAKIMI I PARË I GRUPIT KOORDINUES PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTEVE KURRIKULARE NË ARSIMIN E PËRGJITHSHËM PARAUNIVERSITAR F. 7



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

SAMITI I ZGJERIMIT NË BRUKSEL. BE-ja DHE BALLKANI PERËNDIMOR DISKUTOJNË INTEGRIMIN, REFORMAT DHE SIGURINË E RAJONIT

Bruksel, 25 nëntor - Brukseli ka pritur të mërkurën samitin e radhës mes Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku në qendër të diskutimeve do të jenë integrimi i rajonit, forcimi i bashkëpunimit politik dhe përballimi i sfidave të përbashkëta.
Samiti do të drejtohet nga presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, të cilët shpresojnë ta ruajnë ritmin e zgjerimit të bllokut.
Liderët e unionit do ta shqyrtojnë ecurinë e integrimit gradual të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me vëmendje të veçantë te Plani i Rritjes dhe mundësitë për zgjerimin e përfitimeve që ai ofron për rajonin.
Në fokus do të jetë edhe procesi i anëtarësimit të Malit të Zi, i cili synon t'i përmbyllë negociatat për të gjithë kapitujt deri në fund të këtij viti.
Ky samit mund të jetë i fundit ku Shqipëria merr pjesë me statusin e kandidatit, përpara kalimit në fazën e aderimit.



Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit të Malit të Zi, megjithatë, nuk pritet të ndodhë përpara qershorit të vitit të ardhshëm.
Përtej procesit të zgjerimit liderët do të diskutojnë edhe për forcimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rajonit në kushtet e tensioneve ndërkombëtare.
Një nga veçoritë e këtij takimi është mungesa e Serbisë, e cila për të dytën herë radhazi nuk do të përfaqësohet në nivelin më të lartë politik.
Presidenti në detyrë dhe kryetari i Kuvendit të Serbisë, Aleksandar Çupiç, nuk do të jetë i pranishëm, ndërsa mungesa e tij është mirëkuptuar nga zyrtarët evropianë për shkak të situatës tranzitore politike në Beograd pas zgjedhjeve.
Një ndër çështjet kryesore të agjendës pritet të jetë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Liderët evropianë do të nënvizojnë se mungesa e normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve mbetet pengesë për avancimin e tyre drejt integrimit evropian.
Samiti i fundit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor u zhvillua në fillim të qershorit në Tivat të Malit të Zi, ku mori pjesë edhe kryeministri shqiptar Edi Rama.

SULM KIBERNETIK NDAJ CIA-s DHE INTELIGJENCËS AMERIKANE, EKSPOZOHEN DISA INFORMACIONE

Uashington, 25 nëntor - Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA) dhe Zyra e Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare në ShBA kanë zbuluar një ndërhyrje kibernetike në sistemet e tyre, përmes së cilës janë ekspozuar disa informacione të paklasifikuara. Lajmi është raportuar nga gazeta amerikane "The New York Times", duke iu referuar zyrtarëve amerikanë dhe personave të njohur me çështjen. Sipas raportimit, ndërhyrja ka prekur një sistem të analizës së inteligjencës me burime të hapura, një rrjet kompjuterik që përdoret për të identifikuar informacione me vlerë për inteligjencën përmes materialeve publike dhe të paklasifikuara.
Deri më tani nuk është bërë me dije se cilat informacione janë kompromet uar konkretisht.
Megjithatë, burimet e cituara nga gazeta theksojnë se materialet e klasifikuara nuk janë vënë në rrezik. Dy prej personave të njohur me rastin kanë bërë me dije se ekspozimi mund të ketë prekur edhe informacione në agjenci të tjera qeveritare amerikane. Njëri prej tyre tha se problemi tashmë është zgjidhur.
Sistemet e inteligjencës me burime të hapura përdorin një sasi të madhe të dhënash, përfshirë informacione të disponueshme në treg, përmbajtje nga rrjetet sociale, imazhe satelitore dhe materiale të tjera në internet.
Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e këtyre të dhënave është publike, disa prej tyre sigurohen përmes kompanive që ofrojnë informacione kundrejt pagesës. Kur kombinohen me burime të tjera, këto të dhëna mund të zbulojnë informacione të rëndësishme dhe mjaft të hollësishme.
Agjencitë e inteligjencës i përdorin ato së bashku me burime të tjera për të ndërtuar analiza dhe vlerësime mbi çështje të ndryshme të sigurisë. Sipas burimeve të "The New York Times", në këtë rast dyshohet se një haker ka arritur të sigurojë qasje të paautorizuar në të paktën një sistem



qeveritar. Megjithatë, nuk është bërë me dije nëse hetuesit kanë identifikuar personin ose grupin përgjegjës për ndërhyrjen.
Një zyrtar i Zyrës së Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare deklaroi se incidenti nuk ka shkaktuar ndërprerje të kapaciteteve kritike, ndërsa CIA nuk pranoi të komentojë.
Ky incident vjen në një periudhë kur disa institucione amerikane kanë raportuar probleme dhe ndërhyrje në sistemet e tyre teknologjike. Javën e kaluar Agjencia e Sigurisë Kombëtare (NSA) përjetoi një ndërprerje disa ditore të rrjetit të saj të brendshëm të klasifikuar. Sipas zyrtarëve dhe bizneseve të përfshira, problemi nuk ishte shkaktuar nga sulme kibernetike.
Po gjatë javës së kaluar u raportua edhe për një ndërhyrje në Qendrën Kombëtare të Informacionit të Krimeve të FBI-së, një bazë të dhënash në nivel kombëtar që përdoret nga institucionet lokale, shtetërore dhe federale të zbatimit të ligjit për shkëmbimin e informacioneve mbi personat e dyshuar për vepra penale.
Presidenti amerikan Donald Trump iu referua këtij incidenti gjatë një interviste telefonike për "Fox News" të shtunën. "Do të them se kjo nuk është diçka e mirë, nuk më pëlqen", deklaroi Trumpi kur u pyet për ndërhyrjen në sistemin e FBI-së.
Edhe Departamenti Amerikan i Bujqësisë zbuloi një incident të sigurisë kibernetike, i cili detyroi institucionin të çaktivizonte përkohësisht disa aplikacione të brendshme. Lajmi u raportua fillimisht nga Nextgov, një platformë që mbulon zhvillimet teknologjike në institucionet federale amerikane.
Drejtori i Inteligjencës Kombëtare, Jay Clayton, i cili së fundmi është emëruar nga Trump edhe në rolin e drejtorit në detyrë për sigurinë kibernetike, u përpoq t'i qetësonte shqetësimet publike gjatë disa daljeve televizive të dielën.
Duke komentuar ndërhyrjen në bazën e të dhënave të FBI-së, ai tha se incidente të tilla nuk janë të pazakonta dhe nuk ka arsye për alarm. "Hetimet kibernetike dhe incidentet kibernetike kanë qenë pjesë e ekonomisë amerikane dhe e jetës amerikane për një kohë të gjatë", u shpreh Clayton në emisionin "This Week" të ABC-së.
Ai shtoi se, lidhur me incidentin në FBI, institucioni po merrej me situatën sipas procedurave të zakonshme. Ndërsa autoritetet amerikane po përpiqen të sqarojnë shtrirjen e ndërhyrjeve të fundit, mbetet ende e paqartë se kush qëndron pas sulmit ndaj sistemeve të inteligjencës dhe sa të dhëna janë ekspozuar.

PA PRANINË E MEDIEVE, TRUMPI DEKORON RUDY GIULIANIN NË ZYRËN OVALE

Uashington, 25 nëntor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka akorduar ish-kryebashkiakut të Nju-Jorkut, Rudy Giuliani, Medaljen Presidenciale të Lirisë, një prej dekoratave më të larta civile në ShBA.
Ceremonia u zhvillua në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë, por pa praninë e gazetarëve, të cilët nuk ishin ftuar për të ndjekur nga afër momentin e dorëzimit të medaljes.
Ish-kryebashkiaku 82-vjeçar ndau disa fotografi nga ceremonia përmes një postimi në rrjetin social X, ku shprehu mirënjohjen për vlerësimin e marrë. "Jam shumë i nderuar. Të bëj gjënë e duhur për të tjerët ka qenë gjithmonë busulla ime", shkroi Giuliani.
Edhe zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Olivia Wales, vlerësoi kontributin e tij në jetën publike amerikane, duke e cilësuar Giulianin si një shërbëtor publik të përkushtuar, lidershipi i të cilit ka lënë gjurmë të pashlyeshme në Nju-Jork dhe në Shtetet e Bashkuara.



Rudy Giuliani u bë i njohur fillimisht për luftën kundër mafias në Nju-Jork, gjatë karrierës së tij si prokuror. Më pas, si kryebashkiak i qytetit, ai mori vëmendje ndërkombëtare për mënyrën se si menaxhoi situatën pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001.
Megjithatë, vitet e fundit reputacioni i tij është dëmtuar ndjeshëm. Në vitin 2023 Giuliani u urdhërua të paguante 148 milionë dollarë dëmshpërblim për shpifje ndaj dy punonjësve zgjedhorë në Xhorxhia, të cilët i kishte akuzuar për përfshirje në manipulimin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020.
Giuliani ishte një prej figurave kryesore që udhëhoqën përpjekjet e Donald Trumpit për ta kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve, të fituara nga demokrati Joe Biden. Pas këtyre zhvillimeve, ai u përjashtua nga shoqatat e avokatëve në Nju-Jork dhe Uashington.
Dhënia e medaljes nga Trumpi vjen në një kohë kur Giuliani vazhdon të jetë një figurë e debatueshme në politikën amerikane, për shkak të rolit të tij në përpjekjet për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2020.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KURTI PARALAJMËRON PROGRAMIN E RI QEVERISËS: JAVËN E ARDHSHME PUBLIKOHET DRAFTI

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se javën e ardhshme do të jetë gati drafti i programit të ri qeverisës, pas zgjedhjes së presidentes së re të Republikës, Justina Shiroka-Pula. Në "Facebook", Kurti ka thënë se me zgjedhjen e presidentes është siguruar stabiliteti institucional për funksionimin demokratik, zhvillimin ekonomik dhe përparimin shoqëror në katërvjeçarin e ardhshëm.

Ai ka theksuar se në programin e ri qeverisës janë përfshirë dhe shtjelluar zotimet me të cilat, sipas tij, Lëvizja Vetëvendosje fitoi sërish zgjedhjet, duke falënderuar qytetarët dhe aktivistët për mbështetjen. "Të dashur qytetarë dhe aktivistë. Pas zgjedhjes së presidentes së re të Republikës, Prof. Dr. Justina Shiroka-Pula, kemi stabilitet të plotë institucional për funksionim demokratik, zhvillim ekonomik dhe përparim shoqëror në katërvjeçarin para nesh. Javën e ardhshme do ta kemi gati draftin e programit tonë të ri qeverisës ku janë bërë bashkë dhe shtjelluar zotimet tona me të cilat fituam përsëri zgjedhjet me votën dhe mbështetjen tuaj. Në themel të fitores sonë është besimi juaj që është përgjegjësi për ne, por edhe sukseset e përbashkëta e të arriturat e shumta në këto vitet e fundit. Kurti 1 në vitin 2020 zgjati vetëm 4 muaj (51 ditë me kompetenca të plota), Kurti 3 sivjet zgjati 7 muaj e dy ditë (77 ditë me kompetenca të plota), ndërkaq Kurti 4 nisi më 13 shtator 2026. Mirëpo, të arriturat kryesore për Kosovën dhe qytetarët e saj natyrisht që ishin në Kurti 2. Dhe, në vijim keni përmbledhjen me të arriturat kryesore të Kurti 2", ka shkruar Kurti.



SHQETËSIMET PËR GJYKATËN SPECIALE DHE KËNGËN NACIONALISTE NË BRUKSEL, DISKUTOHEN ME AMBASADORIN E BE-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Në vazhdën e takimeve me ambasadorët e akreditуar në Kosovë, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, i drejtuar nga Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare, takoi të mërkurën ambasadorin e BE-së në Republikën e Kosovës, Dirk Schuebel, me bashkëpunëtorët e tij.

Ky takim ndonëse kishte karakter njohës, u fokusua te nevoja e një bashkëpunimi sa më të thellë dhe cilësor në përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta.

Kryetarja e komisionit, Kryeziu-Hyseni, e falënderoi ambasadorin Schuebel për gatishmërinë e bashkëpunimit, ndërkaq e njoftoi atë për angazhimet lidhur me procesin e integrimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.



Në vijim të takimit u fol edhe për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën si dhe një varg çështjesh që kanë të bëjnë me përshpejtimin e këtij procesi.

Në vijim kryetarja Kryeziu-Hyseni, si dhe anëtarët e komisionit, paraqitën të arriturat, sfidat dhe shqetësimet, me të cilat përballet vendi ynë në rrugën e tij të integrimit.

Ndër shqetësimet e shfaqura me këtë rast nga anëtarët e komisionit, ishte mosreagimi i Komisionit Evropian për Zgjerim pas interpretimit të një kënge me përmbajtje nacionaliste serbe gjatë hapjes së Forumit të Zgjerimit në Bruksel.

Po ashtu, komisioni paraqiti vërejtje për sa i përket dënimit të shqiptuar ndaj ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale, duke e cilësuar atë të padrejtë dhe të ndikuar politikisht.

Lidhur me çështjet e ngritura gjatë debatit, ambasadori i BE-së në Kosovë, Dirk Schuebel, e informoi Komisionin për qëndrimin e BE-së, ndërsa nënvizoi domosdoshmërinë e konsultimeve paraprake ndërmjet institucioneve të vendit dhe Zyrës së BE-së.

Në vijim të fjalës së tij, ambasadori Schuebel i siguroi anëtarët e komisionit se BE-ja mbetet e përkushtuar në mbështetje të Kosovës në rrugën e saj të integrimit, ndërkaq vlerësoi se bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë është rruga e vetme e suksesit të përbashkët.

SIGURIA DHE TË DREJTAT E GRAVE NË FOKUS TË TAKIMIT TË HAXHIUT ME DEPUTETE E ASAMBLISTE

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka zhvilluar një diskutim me deputete, asambliste dhe përfaqësuese të organizatave joqeveritare, me rastin e hapjes së fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Përmes një postimi, Haxhiu bëri me dije se në këtë takim u diskutuan përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal për garantimin e sigurisë dhe të drejtave të grave. Ajo theksoi rëndësinë e përfshirjes së asamblisteve në këtë proces, duke vlerësuar se shumë prej problemeve me të cilat përballen gratë në përditshmëri kërkojnë zgjidhje në nivel komunal. Sipas saj, komunat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta në çështje që lidhen me sigurinë në hapësirat publike, funksionimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjen për gratë që përjetojnë dhunë.



Haxhiu bëri me dije se në Kuvendin e Kosovës ka nisur edhe hartimi i Agjendës Parlamentare për Çështje të Grave dhe Barazi Gjinore 2027-2030. Ajo tha se përmes konsultimeve me organizatat e grave në të shtatë rajonet e Kosovës synohet të identifikohen nevojat për ndërhyrje ligjore, mangësitë në zbatimin e ligjeve dhe fushat ku nevojitet mbikëqyrje më e rreptë parlamentare.

Gjatë takimit diskutimet u përqendruan edhe te përvoja e grave në politikë, gjuha seksiste dhe përgjegjësia për ndryshimin e kulturës së debatit në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale.

Presidentja Shiroka Pula themeloi Këshillin Presidencial për Fuqizimin e Grave, Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Grave

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, ka themeluar Këshillin Presidencial për Fuqizimin e Grave, Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Grave, si platformë shtetërore me misionin për t`i avancuar të drejtat, sigurinë, pjesëmarrjen dhe pavarësinë ekonomike të grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën.

Në vazhdën e aktiviteteve të fushatës globale "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore", presidentja Shiroka Pula ritheksoi se fuqizimi i grave nuk është vetëm çështje e përfaqësimit apo e barazisë formale, por çështje e drejtësisë, dinjitetit njerëzor, demokracisë dhe së ardhmes së vendit. Ajo theksoi se garantimi i të drejtave, sigurisë dhe mundësive të barabarta për gratë dhe vajzat kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe përgjegjësi të përbashkët institucionale e shoqërore.

Prioritet qendror i Këshillit do të jetë fuqizimi ekonomik dhe financiar i grave si dhe adresimi i dhunës ndaj tyre.





KOSOVA RREZIKON HUMBJE PËRTEJ SPORTIT NËSE S'I ORGANIZON LOJERAT MESDHETARE

Kosova rrezikon të humbë të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare 2030 për shkak të mospajtimeve institucionale ndër të tjera. Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare do ta shqyrtojë situatën në Kosovë në mbledhjen e 19 dhjetorit. Sipas ekspertëve, humbja e së drejtës së organizimit do ta dëmtonte imazhin ndërkombëtar të Kosovës, do ta privonte ekonominë nga mundësitë për përfitime dhe do t'i rrezikonte investimet e planifikuara në infrastrukturë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Vonesat në përgatitje, mospajtimet mes institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe detyrimet e papërmbushura financiare po vënë në pikëpyetje mbajtjen e Lojërave Mesdhetare në Kosovë më 2030.

Lojërat Mesdhetare janë një ngjarje me shumë sporte, që zhvillohet çdo katër vjet dhe cilësohet si një ndër më të rëndësishmet pas Lojërave Olimpike.

Kosova nuk ka qenë asnjëherë mikpritëse e ndonjë ngjarjeje të përmasave të këtyre lojërave.

Prandaj, humbja e së drejtës për t'i organizuar ato mund të ketë pasoja që shkojnë përtej fushës sportive.

Pse po vihen në pikëpyetje lojërat?

Përgatitjet për organizimin e Lojërave Mesdhetare po pengohen nga një sërë çështjesh që ende presin zgjidhje. Në plan të parë janë detyrimet financiare ndaj Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), por edhe mungesa e pajtimit për planin organizativ.

Situata është bërë më urgjente për shkak të dy garancive të papaguara financiare për vitin 2026, në vlerë prej rreth dy milionë eurosh. Për këtë arsye, ICMG-ja ka refuzuar së fundmi një takim me Kosovën. Për më tepër, organizata ka paralajmëruar se Komiteti i saj Ekzekutiv do t'i shqyrtojë "papërgjegjësitë" e Kosovës në një takim më 19 dhjetor.

Mosrealizimi i këtyre pagesave lidhet me mospajtimet ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal.

Për organizimin e këtyre lojërave janë përgjegjëse tri institucione: Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Sportit; komuna e Prishtinës, si komuna mikpritëse; dhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Kryeministri Albin Kurti, duke folur në Kuvendin e Kosovës më 19 nëntor, pranoi se mungesa e bashkëpunimit mes qeverisë së tij dhe komunës së Prishtinës, që udhëhiqet nga Përparim Rama i Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë, po e vë në rrezik zhvillimin e këtyre lojërave për herë të parë në Kosovë. "Bashkëpunimi, komunikimi ynë me Komitetin Olimpik të Kosovës ka qenë tejet i mirë. Por, kjo nuk mund të thuhet edhe me Komunën e Prishtinës, prandaj edhe ndodhemi në këtë situatë të nxehtë", tha Kurti.

Kurti e akuzoi Ramën se nuk po pajtohet me përmbajtjen e masterplanit i cili përcakton infrastrukturën e nevojshme dhe vendet ku do të zhvillohen garat në 24 sporte.

Ky dokument duhet të miratohet nga Komiteti Organizativ i Lojërave Mesdhetare dhe t'i dërgohet më pas ICMG-së. "Unë vazhdoj të jem optimist, por natyrisht jam optimist i përmbajtur, për shkak se kush bën mirë, nuk e ka kollaj të shtyhet me dikë që e bën të kundërtën", tha Kurti.

Mospajtimet mes tyre, ndër të tjera, kanë të bëjnë edhe me qytetet ku duhet të zhvillohen garat e ndryshme.

Rama iu përgjigj Kurtit po të njëjtën ditë, duke thënë se qeveria e tij është përgjegjëse për gjendjen rreth organizimit të këtyre lojërave. "Pagesa s'është kryer. Emrat e delegacionit s'janë dërguar. Nuk jeni përgjigjur në email-e. Kush është dashur t'i bëjë këto? Qeveria", shkroi Rama në Facebook, më 19 nëntor.

Komiteti Olimpik i Kosovës tha për Radion Evropa e Lirë se është ftuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare për një takim më 3 dhe 4 dhjetor në Athinë, ku do të diskutohet për ngecjet në përgatitjet për Lojërat Mesdhetare 2030.

KOK-u rikonfirmoi përkushtimin për mbajtjen e lojërave në Kosovë, duke theksuar se suksesi i organizimit varet nga angazhimi i të gjitha institucioneve të përfshira.

Çfarë humb Kosova nëse nuk i organizon lojërat?

Mbetet e paqartë nëse Kosova do t'ia dalë t'i adresojë shqetësimet e ICMG-së para mbledhjes së 19 dhjetorit dhe ta ruajë të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare.

ICMG-ja paralajmëroi në tetor se, gjatë mbledhjes së 19 dhjetorit, mund të vendoset për thirrjen e një Asambleje të Jashtëzakonshme të Përgjithshme, në të cilën do të përcaktohej e ardhmja e Lojërave Mesdhetare 2030.

Bekim Salihu, analist politikash në Institutin GAP në Prishtinë, thotë për Radion Evropa e Lirë se pasojat nuk do të ishin vetëm sportive, por edhe ekonomike, institucionale dhe diplomatike. "Humbja e organizimit të lojërave do të dëmtonte besueshmërinë e Kosovës, sidomos nëse do të lidhej me mospërmbushjen e zotimeve", thekson Salihu.

Po ashtu, do të humbej edhe një mundësi e rëndësishme për promovimin ndërkombëtar të vendit, sipas tij.

Kur Kosova e fitoi të drejtën për organizimin e këtyre lojërave në vitin 2023, Kurti i kishte cilësuar ato si ngjarjen më të madhe sportive në historinë e vendit, përmes së cilës, besonte se do të promovohej Kosova në rrafshin ndërkombëtar.

Christian Krekel, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës (LSE), thotë për Radion Evropa e Lirë se humbja e së drejtës për organizimin e lojërave nuk do t'i ndihmonte aspak imazhit të Kosovës jashtë vendit. "Nëse s'e bëni atë që keni marrë përsipër ta bëni, atëherë natyrisht se do të dërgoni mesazh të keq", thotë Krekel.

Një shembull i pasojave që mund të sjellë dështimi i organizimit të një ngjarjeje të madhe sportive është ai i shtetit australian të Viktorias, i cili në vitin 2023 hoqi dorë nga mbajtja e Lojërave të Komonuelthit 2026, për shkak të rritjes së kostove.

Një raport i Auditorit të Përgjithshëm të Viktorias

konstatoi se kostot e organizimit ishin nënvlerësuar që në fillim.
Në rritjen e tyre ndikuan nevojat për investime infrastrukturore, shpërndarja e garave në disa qytete, zgjerimi i programit sportiv, inflacioni dhe koha e kufizuar për përgatitje.
Edhe pse lojërat nuk u zhvilluan në Viktoria, përgatitjet dhe tërheqja nga organizimi i kushtuan këtij shteti të paktën 589 milionë dollarë australianë.
Një raport i Senatit australian evidentoi se ky vendim ngriti shqetësime edhe për reputacionin e Viktorias dhe të Australisë si destinacione për organizimin e ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare.

Ekonomia

Salihu thotë se, nëse Lojërat Mesdhetare nuk do të zhvilloheshin në Kosovë më 2030, turizmi, hoteleria, gastronomia, transporti dhe sektorë të tjerë të shërbimeve do të humbnin mundësinë për të përfituar nga shpenzimet e vizitorëve dhe pjesëmarrësve.
Megjithatë, ai nënvizon se, pa një vlerësim të besueshëm, nuk mund të përcaktohet se sa do të ishin këto humbje.
Në Lojërat Mesdhetare të vitit 2030 pritet të marrin pjesë delegacione nga 26 shtete të Evropës, Afrikës dhe Azisë.
Garat parashihet të zhvillohen në të paktën dhjetë qytete të Kosovës, ndërsa në to pritet të marrin pjesë rreth 5 000 sportistë.
Përveç sportistëve dhe delegacioneve, në Kosovë do të vinin edhe tifozë, familjarë të garuesve, gazetarë dhe zyrtarë sportivë.
Kjo do të krijonte kërkesë për akomodim, ushqim, transport dhe shërbime të tjera në disa prej qyteteve ku do të zhvilloheshin garat.
Përmasat e një ngjarjeje të tillë janë dëshmuar edhe në edicionet e mëparshme.
Në Lojërat Mesdhetare të këtij viti, të mbajtura në Taranto të Italisë, u shitën 172 500 bileta, ndërsa ngjarja tërhoqi mbi 8 000 vizitorë, sipas të dhënave të organizatorëve.
Edhe edicioni i vitit 2022, në Oran të Algjerisë, ngjalli interesim të madh.
Ceremonitë e hapjes dhe të mbylljes së lojërave u ndoqën nga rreth 40 000 spektatorë secila, ndërsa shumë prej garave sportive u zhvilluan para tribunave të mbushura.
Në Kosovë ka, gjithashtu, dëshmi për interesimin e madh të publikut për ngjarjet sportive.
Vendi, i cili ka një nga popullsitë më të reja në Evropë, ka shënuar vazhdimisht kërkesë të lartë për bileta në ndeshjet e përfaqësueseve të tij kombëtare.
Në disa raste, interesimi për ndeshjet e Kombëtares së Kosovës në futboll ka tejkaluar kapacitetin e stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë, me bileta që janë shitur brenda një kohe të shkurtër.
Interesim të ngjashëm mund të ketë edhe për garat e Lojërave Mesdhetare, veçanërisht për sportet në të cilat Kosova ka shënuar suksese ndërkombëtare.
Xhudoja, si sporti që i ka sjellë Kosovës më së shumti medalje, mund të jetë ndër disiplinat që do të tërhiqnin më shumë spektatorë.

Infrastruktura

Qeveria e Kosovës ka paraparë një buxhet prej 250 milionë eurosh për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme sportive për Lojërat Mesdhetare.
Kosova e fitoi të drejtën për organizimin e këtyre lojërave në vitin 2023, megjithëse në atë kohë i mungonte një pjesë e madhe e infrastrukturës së nevojshme sportive.
Tre vjet më vonë, përgatitjet infrastrukturore vazhdojnë të jenë prapa planit.
Nëse Kosova humb të drejtën për organizimin e lojërave, rrezikohen edhe investimet e planifikuara.
Projektet që ende nuk kanë nisur, mund të rishikohen ose të anulohen, ndërsa ndërprerja e projekteve që janë në realizim, mund të sjellë edhe kosto kontraktuale. "Rreziku ekziston nëse humbet financimi ose urgjenca politike për përfundimin e tyre. Secili projekt duhet të vlerësohet sipas kostos së mbetur, dobisë publike dhe planit të mirëmbajtjes", nënvizon Salihu.
Ndër projektet ku punimet vazhdojnë, është rindërtimi i stadiumit "Adem Jashari" në Mitrovicë të Jugut.
Stadiumi, i paraparë për përdorim olimpik dhe multifunksional, pritet të ketë rreth 18 000 ulëse. Megjithatë, ende nuk dihet se kur do të përfundojnë punimet.
Një tjetër projekt në realizim është pishina e mbyllur olimpike në Podujevë, e cila po ndërtohet për garat e notit gjatë Lojërave Mesdhetare.
Përgatitjet për Fshatin Mesdhetar, ndërkaq, janë përqendruar në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.
Projekti përfshin konviktet, palestrën "1 Tetori", mensën e studentëve, qendrën e shërbimeve shëndetësore dhe ndërtesat e tjera përcjellëse, si dhe sallat e edukatës fizike të 12 shkollave të kryeqytetit.
Për këtë projekt është miratuar një kredi prej 42 milionë eurosh nga Agjencia Franceze për Zhvillim.
Sipas Ministrisë së Sportit, punimet parashihet të nisin në fillim të vitit 2027.
Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, ku planifikohet të zhvillohen garat në ambiente të mbyllura, është një tjetër objekt që kërkon investime.
Në kohën e raportimit, Kosova vazhdon bisedimet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për sigurimin e kredisë për rindërtimin e tij.
Por, ndër projektet kryesore që ende nuk kanë hyrë në fazën e ndërtimit, është Stadiumi Kombëtar.
Sipas Ministrisë së Sportit, lokacioni i tij ende nuk është përcaktuar.
Si mundësi për ndërtimin e tij janë përmendur Zona Industriale në Drenas dhe Bërnica.
Stadiumi parashihet të ketë së paku 25 000 ulëse dhe të shërbejë për ceremonitë zyrtare të hapjes dhe mbylljes së Lojërave Mesdhetare.
Sipas planifikimit, Kosova ka kohë deri në vitin 2029 për t'i përfunduar përgatitjet organizative dhe infrastrukturore për Lojërat Mesdhetare, të cilat parashihet të mbahen nga 24 korriku deri më 4 gusht 2030.

Çfarë janë Lojërat Mesdhetare?

Lojërat Mesdhetare janë një ngjarje shumësportëshe që organizohet çdo katër vjet dhe bashkon sportistë nga vendet e pellgut të Mesdheut, që përfaqësojnë tri kontinente: Evropën, Afrikën dhe Azinë. Ato u organizuan për herë të parë në vitin 1951, në Aleksandri të Egjiptit, me pjesëmarrjen e dhjetë shteteve dhe 734 sportistëve.
Sot, Lojërat Mesdhetare janë një ndër ngjarjet më të rëndësishme shumësportëshe pas Lojërave Olimpike dhe organizohen nën patronatin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC).
Në edicionin e vitit 2022, në Oran të Algjerisë, morën pjesë 26 shtete dhe 3.298 sportistë.
Në edicionin e vitit 2026, në Taranto të Italisë, numri i sportistëve arriti në 3 803.
Për edicionin e vitit 2030 në Prishtinë, ICMG-ja ka përcaktuar në fazën e parë një program bazë prej 24 sportesh. Ato përfshijnë: atletikën, notin, vaterpolon, basketbollin 3x3, hendbollin, volejbollin, futbollin në sallë (futsal), boksin, xhudon, karatenë, taekwondon, mundjen, çiklizmin, gjimnastikën, tenisin, pingpongun, badmintonin, kanotazhin, lundrimin me vela, qitjen, gjuajtjen me hark, peshëngritjen, padelin dhe ngjitjen sportive.
Për organizimin e Lojërave Mesdhetare, Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Shqipërinë. Meqë Kosova nuk ka dalje në det, garat e lundrimit me vela janë paraparë të zhvillohen në Durrës.



Kosova dhe Shqipëria shkëmbejnë përvojat ushtarake

Prishtinë, 25 nëntor - Gjeneralmajor Ferdinant Dimo, komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh), së bashku me delegacionin shoqërues, realizoi një vizitë zyrtare dyditore në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).
Delegacioni i FARSh-së u prit nga gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, komandant i KDS-së, së bashku me lidershipin e kësaj komande.
Gjatë vizitës u zhvilluan takime dhe diskutime lidhur me bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy institucioneve, si dhe mundësitë për avancimin e mëtejshëm të tij, me theks të veçantë në fushën e edukimit, arsimimit dhe zhvillimit profesional të pjesëtarëve të të dyja forcave.
Vizita shërbeu si mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe identifikimin e mundësive të reja të bashkëpunimit, duke riafirmuar përkushtimin e përbashkët të FSK-së dhe FARSh-së për thellimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale.



RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS KËRKON QË FEMICIDI TË NJIHET SI VEPËR E VEÇANTË PENALE



Prishtinë, 25 nëntor - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kërkuar që femicidi të njihet si vepër e veçantë penale në Kodin Penal të Kosovës si dhe të krijohet një mekanizëm i posaçëm për monitorimin dhe analizimin e rasteve të vrasjeve të grave. Këto kërkesa u paraqitën gjatë protestës me moton "Kundër vrasjes së grave - Femicidi është urgjencë kombëtare", e cila u mbajt të mërkurën në Prishtinë, me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe fillimit të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.
Protesta nisi në sheshin "Zahir Pajaziti" dhe përfundoi para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, ku aktivistet paraqitën kërkesat dhe mesazhet e tyre drejtuar institucioneve.
Aktivistja Zana Hoxha tha se një nga kërkesat kryesore është që femicidi të përcaktohet si vepër e veçantë penale, në mënyrë që vrasjet e grave për shkak të gjinisë së tyre të emërtohen dhe të hetohen në këtë kontekst. Ajo kërkoi gjithashtu krijimin e mekanizmit "Femicide Watch", i cili do të mundësonte monitorimin dhe analizimin e rasteve të vrasjeve të grave, përfshirë edhe ato të viteve të kaluara, me qëllim të identifikimit të përgjegjësive institucionale dhe mundësive të humbura për parandalimin e tyre.
Ndërkaq, përfaqësuesja e RrGK-së, Besarta Bresnica, në emër të rrjetit dhe 108 organizatave anëtare, u bëri thirrje institucioneve që femicidin ta trajtojnë me urgjencën dhe seriozitetin e nevojshëm. "Në emër të Rrjetit të Grave të Kosovës dhe 108 organizatave tona anëtare, sot kërkojmë që institucionet e Republikës së Kosovës ta trajtojnë femicidin me urgjencën dhe seriozitetin që kërkon", deklaroi Bresnica.
Ajo përmendi edhe rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt, duke kërkuar përgjegjësi institucionale për mënyrën se si ishin trajtuar raportimet dhe kërkesat e saj për mbrojtje.

KOMISIONI SHQYRTON ZBATIMIN E LIGJEVE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE



Prishtinë, 25 nëntor - Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i kryesuar nga Slavko Simiç, ka shqyrtuar gjendjen e zbatimit të legjislacionit që garanton të drejtat e komuniteteve në Kosovë.
Në hapje të mbledhjes, Simiç u uroi mirëseardhje anëtarëve të rinj të komisionit, duke shprehur bindjen se përvoja e tyre do të kontribuojë në punën e këtij organi gjatë mandatit aktual.
Në hapje të mbledhjes, Simiç u uroi mirëseardhje anëtarëve të rinj të komisionit, duke shprehur bindjen se përvoja e tyre do të kontribuojë në punën e këtij organi gjatë mandatit aktual. Ai theksoi rolin kushtetues të komisionit si forum i bashkëpunimit dhe dialogut, në frymën e respektit të ndërsjellë, si dhe mundësinë që përmes tij të kërkohen raporte nga institucionet për politikat që prekin komunitetet.
Gjatë diskutimeve, deputetë nga komuniteti serb ngritën shqetësime lidhur me zbatimin në praktikë të garancive ligjore, duke kërkuar që komisioni të përcjellë miratimin dhe zbatimin e ligjeve që prekin të gjitha komunitetet.
Ndërkaq, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, vlerësoi se Kosova ka një kornizë ligjore të avancuar për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Ai theksoi rëndësinë e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve, ruajtjes së mekanizmave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe marrjes parasysh të interesave të tyre gjatë shqyrtimit të legjislacionit.
Pas diskutimeve për zbatimin e garancive ligjore dhe përfaqësimin e komuniteteve, komisioni përmbylli mbledhjen.

IKShPK bën thirrje për kujdes me antibiotikët: Mos i përdorni për grip dhe ftohje

Prishtinë, 25 nëntor - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë thirrje për përdorim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm të antibiotikëve, në kuadër të Javës Botërore të Ndërgjegjësimit për Rezistencën Antimikrobike.
Përmes një njoftimi në "Facebook", IKShPK ka rikujtuar se antibiotikët nuk janë gjithmonë zgjidhja dhe se përdorimi i tyre pa nevojë mund të kontribuojë në rezistencën antimikrobike.
Instituti ka këshilluar qytetarët që të mos përdorin antibiotikë për ftohje, grip apo dhimbje fyti me origjinë virale, të mos i ndajnë me persona të tjerë dhe të mos i ruajnë mbetjet e tyre për përdorim të mëvonshëm.
IKShPK thekson se antibiotikët duhet të përdoren vetëm sipas këshillave të profesionistëve shëndetësorë. "Përdorimi i përgjegjshëm i antibiotikëve sot, mbron shëndetin e të gjithëve nesër", thuhet në apelin e Institutit.



PRESIDENTJA SHIROKA PULA: 28 NËNTORI BASHKON HISTORINË, SAKRIFICËN DHE IDENTITETIN TONË KOMBËTAR

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, me rastin e 28 Nëntorit. Në fjalën e saj, presidentja Shiroka Pula tha se flamuri kuq e zi, me shqiponjën dykrenare, përfaqëson simbolin e shtetit shqiptar dhe të gjithë kombit shqiptar, kudo që jeton. Ajo rikujtoi shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në krye me Ismajl Qemajlin, duke theksuar kontributin e patriotëve nga të gjitha trevat shqiptare, përfshirë Hasan Prishtinën dhe Isa Boletinin.

Presidentja theksoi se flamuri kuq e zi u bë simbol i qëndresës dhe i luftës çlirimtare të Kosovës, ndërsa 28 Nëntori përfaqëson katër ngjarje të rëndësishme: Ditën e Flamurit dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari dhe daljen e parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo vlerësoi sakrificën e familjes Jashari dhe theksoi se lufta e UÇK-së ishte luftë për liri dhe për të drejtën e popullit të Kosovës për të jetuar i lirë në vendin e vet.



Duke iu referuar procesit gjyqësor në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, presidentja Shiroka Pula tha se asnjë proces gjyqësor nuk mund ta zhbëjë të drejtën e popullit të Kosovës për liri dhe sakrificën mbi të cilën u ndërtua ajo.

Presidentja përgëzoi Shqipërinë për përparimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke shprehur urimin që flamuri kuq e zi së shpejti të valëvitet edhe në Bruksel.

Presidentja Shiroka Pula bëri thirrje që flamuri të nderohet me punë, dije dhe përkushtim, të ruhen gjuha, identiteti dhe kujtesa historike, si dhe të mos harrohet çmimi i lirisë. Ajo theksoi se flamuri që valëvitet sot është amanet i brezave që luftuan, sakrifikuan dhe dhanë jetën për të.

Në fund ajo u bëri thirrje për forcimin e lidhjeve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, duke theksuar nevojën për më shumë integrim ndërmjet dy vendeve: "Më shumë Kosovë në Shqipëri dhe më shumë Shqipëri në Kosovë, deri te dita kur së bashku do të ngremë dolli në Bruksel!"

PLATFORMA EKOSOVA OFRON MBI 340 SHËRBIME ELEKTRONIKE PËR MË SHUMË SE 1.2 MILION PËRDORUES

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Ministri i Administratës Publike dhe Digjitalizimit, Lulëzon Jagxhiu, ka bashkëkryesuar në Prishtinë, së bashku me shefin e Njësisë për Kosovën në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim dhe Fqinjësi Lindore (DG ENEST) të Komisionit Evropian, Jiri Plecity, Takimin e 14-t të Grupit të Veçantë për Reformën e Administratës Publike ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Gjatë këtij takimi është diskutuar përparimi në reformën e administratës publike, sfidat e mbetura dhe prioritetet për periudhën e ardhshme në kuadër të procesit të integrimit evropian.



Ministri Jagxhiu ka paraqitur avancimin e reformave në shërbimin civil, përfshirë fillimin e rekrutimit të centralizuar, miratimin e rregulloreve për organizimin e brendshëm të institucioneve dhe racionalizimin e agjencive.

Ai ka theksuar se platforma eKosova tashmë ofron mbi 340 shërbime elektronike për më shumë se 1.2 milion përdorues të regjistruar, ndërsa përmes programit për zvogëlimin e barrës administrative janë thjeshtuar mbi 730 shërbime publike.

Jagxhiu ka veçuar edhe lansimin e Platformës Kombëtare të Identifikimit Elektronik dhe Kuletës Digjitale si dhe ndërlidhjen teknike të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me sistemin e pagave të Thesarit. Sipas tij, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2026 njeh progresin në disa prej këtyre fushave, përfshirë rekrutimin e centralizuar, zvogëlimin e barrës administrative dhe zgjerimin e shërbimeve digjitale.

Ministri Jagxhiu ka theksuar se prioritet mbetet zbatimi i reformave dhe shndërrimi i tyre në rezultate konkrete e të matshme, duke nënvizuar se cilësia e administratës publike vlerësohet edhe përmes funksionimit të institucioneve dhe shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Në fund ai ka falënderuar Komisionin Evropian, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe OECD/SIGMA për bashkëpunimin dhe mbështetjen në avancimin e reformës së administratës publike.

MBAHET TAKIMI I PARË I GRUPIT KOORDINUES PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTEVE KURRIKULARE NË ARSIMIN E PËRGJITHSHËM PARAUNIVERSITAR

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 25 nëntor - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku, mori pjesë në takimin e parë të Grupit Koordinues për rishikimin e dokumenteve kurrikulare në arsimin e përgjithshëm parauniversitar.

Ky proces do të përfshijë rishikimin e kornizës kurrikulare, kurrikulave bërthamë dhe programeve lëndore, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në procesin mësimor dhe në cilësinë e arsimit.

Në këtë takim u diskutua për objektivat dhe drejtimet kryesore të këtij angazhimi, si dhe rëndësinë e përshtatjes së tyre me nevojat aktuale të sistemit arsimor dhe me orientimet e Strategjisë së Arsimit 2035+.

Takimi shënon hapin e parë drejt një procesi të strukturuar të rishikimit të kurrikulave, i cili do të vijojë përmes punës së Grupit Koordinues dhe bashkëpunimit me aktorët relevantë të fushës së arsimit.

Grupi Koordinues për Rishikimin e Dokumenteve Kurrikulare në Arsimin e Përgjithshëm Parauniversitar ka këtë përbërje: Anita Kadriu, Departamenti i Arsimit Parauniversitar, kryesuese; Albërie Sejdiu, Divizioni për kurrikula dhe tekste shkollore, anëtare; Nazan Safçi, Divizioni për arsimin e komuniteteve, anëtare; Selim Mehmeti, Instituti Pedagogjik i Kosovës, anëtar; Blerim Saqipi, Universiteti i Prishtinës, anëtar; Naser Zabeli, Universiteti i Prishtinës, anëtar; Dukagjin Pupovci, ekspert, anëtar; Xhavit Rexhaj, ekspert, anëtar; Rinor Qehaja, ekspert, anëtar; Agron Dida, ekspert, anëtar; Muhamet Gjoka, AKK Kolegjiumi për arsim, anëtar; Edi Puka Gaxha, mësimdhënëse, anëtare; Albana Kelmendi, mësimdhënëse, anëtare; Kushtrim Bekteshi, mësimdhënës, anëtar.



Prishtina siguron 19 vende pune për gratë viktima të dhunës në familje

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se kryeqyteti ka siguruar 19 vende pune për gratë viktima të dhunës në familje. Përmes një postimi, Rama bëri me dije se për këtë qëllim ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. Sipas Ramës, memorandumi synon ta mbështesë punësimin dhe fuqizimin e grave që kanë qenë viktima të dhunës në familje, duke u krijuar mundësi për pavarësi ekonomike dhe integrim në tregun e punës. "Kryeqyteti Prishtina ju ka n'mendje!", ka shkruar Rama në postimin e tij.



ZRRE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë diskutojnë për zhvillimet në sektorin e energjisë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), Driton Gojani, së bashku me anëtarët e Bordit, priti në takim drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Artur Lorkowski, dhe përfaqësuesit e Sekretariatit.

Takimi u përqendrua në zhvillimet aktuale në sektorin e energjisë në Kosovë, me theks të veçantë në procesin e reformimit dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, forcimin e kapaciteteve rregullative dhe thellimin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjithashtu u diskutua për Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe rëndësinë e garantimit të pavarësisë institucionale, funksionale dhe financiare të ZRRE-së, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe parimet e përcaktuara në Direktivën (BE) 2019/944.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë konfirmoi gatishmërinë për ta vazhduar mbështetjen ndaj ZRRE-së në avancimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Në përmbyllje të takimit të dyja palët riafirmuan përkushtimin për vazhdimin e bashkëpunimit institucional dhe avancimin e reformave në sektorin e energjisë, me synim zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm, konkurrues dhe të integruar të energjisë elektrike.



RRETH 39 PËR QIND E ENERGJISË ELEKTRIKE NË VERI NUK ËSHTË FATURUAR GJATË VITIT 2025

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Nga 275 GWh energji elektrike të konsumuara në katër komunat veriore gjatë vitit 2025 janë faturuar vetëm 169 GWh. Sipas kryesuesit të Bordit të ZRrE-së, Driton Gojani, diferenca përfshin humbjet teknike dhe ato komerciale. Këto deklarata Gojani i bëri gjatë raportimit në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion, ku u shqyrtua Raporti Vjetor i Punës së ZRrE-së për vitin 2025.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të kryesuesit të Komisionit, Arben Mustafa, lidhur me dallimin e humbjeve të lejuara në katër komunat veriore dhe pjesën tjetër të Kosovës, Gojani tha se pa përfshirjen e veriut humbjet e lejuara janë 13.3 për qind, ndërsa me përfshirjen e tyre arrijnë në rreth 14.3 për qind. Sipas tij, megjithëse për katër komunat veriore janë lejuar humbje prej 21.5-përqindësh, ndikimi i tyre në nivelin e përgjithshëm të Kosovës është rreth 0.9 pikë përqindjeje.

"21.5 për qind është në raport me energjinë në atë pjesë. Nëse e shohim në total, i bie diku afër 0.9 për qind. Domethënë, prej 13.3-përqindësh që janë të lejuara, për shkak se përfshihet edhe veriu, shkon diku afër 14.3 për qind", deklaroi Gojani.

Mustafa kërkoi gjithashtu të dijë nëse ZRrE-ja ka matje të veçanta për humbjet reale të energjisë në katër komunat veriore.



Gojani tha se ekzistojnë të dhëna për energjinë e pranuar dhe atë të faturuar, duke bërë me dije se gjatë vitit 2025 në këto komuna janë konsumuar rreth 275 gigavat-orë (GWh) energji elektrike, ndërsa janë faturuar vetëm 169 GWh.

Kjo nënkupton se rreth 106 GWh energji nuk janë faturuar, apo afërsisht 39 për qind e energjisë së konsumuar, përcjell Buletini Ekonomik. "Ka matje në kuptim të energjisë e cila pranohet dhe të energjisë që faturohet. Ne e cekëm edhe në përmbledhje që diku nga 275 GWh që janë konsumuar në vitin 2025, janë faturuar 169 GWh, që i bie diku rreth 39 për qind e energjisë e cila nuk është faturuar dhe e cila është humbje. Por aty përfshihen edhe humbjet teknike, edhe humbjet komerciale", deklaroi Gojani.

Ai theksoi se këto të dhëna i referohen vitit 2025, ndërsa shprehu pritjen që situata të ndryshojë gjatë vitit 2026, pas instalimit të njehsorëve inteligjentë në katër komunat veriore. Sipas Gojanit, përmes një projekti të KEDS-it, të financuar nga Bashkimi Evropian, në këto komuna janë instaluar afërsisht 25 mijë njehsorë inteligjentë.

Gojani foli edhe për ndryshimin e konsumit të energjisë elektrike në katër komunat veriore ndër vite, duke krahasuar periudhën kur energjia nuk faturohej me atë pas fillimit të faturimit nga furnizuesi i licencuar. Ai bëri me dije se në vitin 2021, kur energjia elektrike në këto komuna nuk faturohej, konsumi kishte arritur në 372 GWh, ndërsa në vitin 2025 kishte rënë në 275 GWh. Sipas tij, kjo paraqet një reduktim prej rreth 100 GWh. "Është mirë ndoshta të potencohet edhe në fillim se, nëse e marrim vitin 2021, energjia në katër komunat veriore, kur nuk është faturuar, konsumi ka arritur nivelin më të lartë, në 372 GWh. Është fjala për vitin 2021. Ndërsa, me fillimin e faturimit nga furnizuesi i licencuar, konsumi ka rënë në 275 GWh. Domethënë, bëhet fjalë për reduktim të konsumit në vlerën e 100 GWh", deklaroi Gojani.

Gjatë raportimit në Komisionin për Ekonomi, Gojani foli edhe për tarifat e shkyçjes dhe rikyçjes së konsumatorëve, duke thënë se të hyrat nga këto shërbime i zbriten operatorit në fund të periudhës përkatëse dhe u kthehen konsumatorëve.

Kjo deklaratë erdhi pas kundërshtimit të deputetit Ilir Kerçeli, i cili e vlerësoi të padrejtë ngarkimin e qytetarëve me tarifa shtesë për shkyçje dhe rikyçje, krahas borxhit të papaguar të energjisë elektrike. (Buletini Ekonomik)

BQK-ja miraton tri udhëzime për zbatimin gradual të Bankimit të Hapur në Kosovë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka miratuar tri udhëzime që përcaktojnë standardet teknike dhe të sigurisë së ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API), si dhe kërkesat për menaxhimin e pëlqimit të klientëve në kuadër të Bankimit të Hapur (Open Banking).

Miratimi i udhëzimeve shënon një hap të mëtejshëm drejt zbatimit gradual të Bankimit të Hapur në Kosovë, në zbatim të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave dhe të Rregullores së BQK-së për standardet teknike për autentifikim të thelluar të klientit dhe standardet e hapura, të përbashkëta dhe të sigurta të komunikimit.

BQK-ja ka miratuar këto udhëzime: Udhëzimin për profilin e standardeve teknike të API-ve për Bankimin e Hapur; Udhëzimin për sigurinë e API-ve për Bankimin e Hapur; Udhëzimin për menaxhimin e pëlqimit për Bankimin e Hapur.

Bankimi i Hapur u mundëson klientëve që, me pëlqimin e tyre, t'u lejojnë ofruesve të autorizuar ose të regjistruar nga BQK-ja të kenë qasje të sigurt në informacionin e llogarive të tyre të pagesave ose të iniciojnë pagesa nga këto llogari. Klientët vendosin se cilit ofrues i japin pëlqimin, për cilin shërbim dhe për sa kohë dhe mund ta tërheqin atë në çdo kohë.



GJEOGRAFIA E RE E PUSHTETIT: PSE E ARDHMJA E SUPERFUQIVE PO VENDOSET NËN TOKË

Për më shumë se një shekull, nafta ka qenë një nga burimet kryesore të fuqisë ekonomike dhe politike. Por në epokën e inteligjencës artificiale, makinave elektrike dhe teknologjive të avancuara, një grup tjetër lëndësh të para po fiton rëndësi strategjike. Litiumi, kobalti, bakri dhe metalet e rralla po ndryshojnë marrëdhëniet mes shteteve. Dhe beteja nuk zhvillohet vetëm për atë që gjendet nën tokë, por mbi të gjitha për atë që ndodh pasi mineralet nxirren prej saj.



Nëse do të kërkonim një simbol të fuqisë botërore gjatë shekullit XX, ndoshta do të zgjidhnim një pus nafte.

Nafta lëvizte ushtritë, furnizonte fabrikat, përcaktonte aleancat dhe mund të zhyste ekonomi të tëra në krizë. Vendet që zotëronin rezerva të mëdha ose kontrollonin rrugët e transportit të saj kishin në duar një instrument të jashtëzakonshëm ndikimi.

Por në shekullin XXI, harta e fuqive po bëhet më e ndërlikuar. Një makinë elektrike ka nevojë për bateri dhe motorë të specializuar. Një qendër të dhënash që mbështet inteligjencën artificiale kërkon sasi të mëdha bakri, pajisje elektronike dhe energji. Turbinat e erës, avionët luftarakë, robotët industrialë dhe shumë sisteme të tjera të avancuara varen nga materiale për të cilat shumica e njerëzve dinë shumë pak.

Disa prej tyre kanë emra pothuajse të panjohur: neodim, prazeodim, disprozium, terbium. Të tjera janë më të njohura: litium, nikel, kobalt, bakër.

Të gjitha janë pjesë e një transformimi që po ndryshon ekonominë botërore. Por ndryshe nga sa mund të mendohet, vendet që zotërojnë mineralet nuk janë domosdoshmërisht ato që kontrollojnë tregtinë e tyre.

Në këtë ndryshim fshihet një nga paradokset më të mëdha të gjeopolitikës moderne. Pasuria mund të jetë nën tokën e një vendi, ndërsa pushteti ekonomik që buron prej saj mund të ndodhet mijëra kilometra larg.

Pasuria e nëntokës nuk mjafton

Republika Demokratike e Kongos është një nga shembujt më domethënës. Sipas të dhënave të publikuara në qershor 2026 nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, UNCTAD, vendi prodhoi rreth 74 për qind të kobaltit të nxjerrë nga minierat në botë gjatë vitit 2025.

Kobalti përdoret në disa lloje baterish, në lidhje metalike dhe në aplikime industriale me kërkesa të veçanta teknike. Në pamje të parë, një përqendrim kaq i madh i prodhimit duhet t'i jepte Kongos një pozitë jashtëzakonisht të fuqishme në ekonominë botërore. Por historia nuk përfundon në minierë.

Përpara se kobalti të shndërrohet në një material të përshtatshëm për bateritë, ai duhet të përpunohet, të rafinohet dhe të kalojë nëpër një zinxhir të ndërlikuar prodhimi.

Pjesa më e madhe e këtij përpunimi zhvillohet jashtë Kongos, veçanërisht në Kinë. Kjo do të thotë se vendi që nxjerr mineralin dhe vendi që e shndërron atë në një produkt industrial zotërojnë dy lloje të ndryshme pushteti.

I pari kontrollon burimin natyror. I dyti kontrollon një pjesë vendimtare të rrugës që e bën burimin të përdorshëm.

Të zotërosh një rezervë minerare nuk është njësoj si të zotërosh fabrikat, teknologjinë, ekspertizën dhe rjetet tregtare që e kthejnë atë në produkt. Në botën fuqia, pushteti nuk buron vetëm nga ajo që ke. Buron edhe nga ajo që je në gjendje të bësh me të.

Avantazhi që Kina ndërtoi për dekada

Në qendër të kësaj historie ndodhet Kina. Gjatë dekadave të fundit, Pekini ka ndërtuar kapacitete të mëdha për nxjerrjen, përpunimin dhe prodhimin e materialeve strategjike. Rezultati është një pozitë shumë e fortë në disa prej hallkave më të rëndësishme të zinxhirit të furnizimit.

Sipas raportit "Global Critical Minerals Outlook 2026" të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, Kina përbën mbi 90 për qind të furnizimit global të rafinuar për disa materiale, përfshirë galiumin, grafitin dhe manganin, si edhe kategori të caktuara të elementeve të rralla. Për metalet e rralla që përdoren në magnetët e fuqishëm, përqendrimi është veçanërisht i madh.

Këta magnetë gjenden në një gamë të gjerë teknologjish, nga motorët elektrikë te sistemet industriale dhe pajisjet e mbrojtjes. Por ky pozicion nuk u krijua thjesht sepse Kina zotëron rezerva minerare.

Ai është rezultat i investimeve industriale, infrastrukturës, ekspertizës teknologjike, politikave shtetërore dhe zhvillimit të një ekosistemi prodhues që është i vështirë të riprodhohet brenda pak vitesh.

Përpunimi i mineraleve kërkon njohuri të specializuara, energji, pajisje dhe shpesh procese kimike të kushtueshme. Madje, edhe kur një vend tjetër hap një minierë të re, mund t'i duhet ta dërgojë produktin e saj për përpunim jashtë kufijve.

Kjo është arsyeja pse shtetet perëndimore po zbulojnë se hapja e minierave nuk është e mjaftueshme për të zvogëluar varësinë. Ato duhet të ndërtojnë edhe gjithë industrinë që ndodhet mes minierës dhe produktit përfundimtar. Dhe kjo mund të kërkojë shumë më tepër kohë sesa një marrëveshje diplomatike.

Nga nafta te magnetët

Për dekada, siguria energjetike nënkuptonte kryesisht garantimin e furnizimit me naftë dhe gaz.

Shtetet përpiqeshin të siguronin prodhues të besueshëm, rrugë transporti dhe rezerva strategjike.

Sot, një pjesë e kësaj logjike po shtrihet edhe te mineralet. Por ka një ndryshim të rëndësishëm.

Nafta konsumohet vazhdimisht si karburant. Një pjesë e madhe e mineraleve, përkundrazi, përdoret për të ndërtuar pajisje që mund të funksionojnë për vite me radhë dhe materialet e të cilave, në disa raste, mund të riciklohen. Kjo do të thotë se ekonomia e mineraleve nuk është një kopje e ekonomisë së naftës.

Megjithatë, varësitë strategjike mund të jenë po aq serioze. Imagjinoni një fabrikë makinash elektrike që mund të prodhojë pothuajse të gjitha pjesët e automjetit, por nuk ka akses te një komponent i vogël, i domosdoshëm për motorin. E gjithë linja e prodhimit mund të ndërpritet.

Ose një industri e mbrojtjes që zotëron teknologjinë për të ndërtuar një sistem të avancuar, por varet nga një furnizues i vetëm për një material të specializuar. Në këto raste, rëndësia e një lënde të parë nuk përcaktohet vetëm nga çmimi apo sasia e saj, por nga pyetja: çfarë ndodh nëse ajo mungon?

Një material relativisht i lirë mund të ketë rëndësi strategjike jashtëzakonisht të madhe nëse nuk ekziston një zëvendësues i përshtatshëm. Kështu, një pjesë e fuqisë ekonomike moderne mund të qëndrojë në kontrollin

e komponentëve më pak të dukshëm të prodhimit.

Një botë që përpiqet të zvogëlojë varësinë

Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Japonia, Australia dhe partnerë të tjerë po përpiqen të krijojnë zinxhirë furnizimi më të larmishëm.
Qëllimi është të mos varen tepër nga një vend i vetëm për materiale që konsiderohen të domosdoshme për ekonominë dhe sigurinë kombëtare. Por diversifikimi nuk është një proces i thjeshtë.
Një minierë e re mund të kërkojë vite kërkimesh gjeologjike, investime, leje mjedisore dhe ndërtim infrastrukture.
Një fabrikë përpunimi kërkon jo vetëm kapital, por edhe specialistë, teknologji dhe furnizim të qëndrueshëm me lëndë të para.
Për më tepër, kompanitë private nuk investojnë gjithmonë në projekte që kanë rëndësi strategjike për shtetet, nëse fitimet e pritshme nuk justifikojnë rrezikun ekonomik.
Këtu lind një tension i ri mes logjikës së tregut dhe logjikës së sigurisë kombëtare. Një shtet mund të dëshirojë një industri vendase përpunimi edhe nëse materialet e importuara janë më të lira. Një kompani, nga ana tjetër, mund të parapëlqejë furnizuesin më ekonomik, pavarësisht rrezikut gjeopolitik.

Në një analizë të botuar në "Foreign Affairs" më 4 nëntor 2026, Tom Moerenhout dhe Kevin Brunelli e vendosin investimin në qendër të debatit mbi mineralet kritike dhe përpjekjet e Shteteve të Bashkuara e aleatëve të tyre për të konkurruar me Kinën.
Problemi nuk është thjesht të identifikohen mineralet që mungojnë. Është të ndërtohet një sistem ekonomik i aftë t'i prodhojë dhe përpunojë ato në mënyrë të qëndrueshme.

Fuqitë e reja të nëntokës

Në këtë garë, shtete që për një kohë të gjatë janë parë kryesisht si eksportuese të lëndëve të para po kërkojnë një rol më të madh. Indonezia është një shembull i rëndësishëm. Sipas UNCTAD-it, në vitin 2025 ajo përbënte rreth 67 për qind të prodhimit botëror të nikelit nga minierat. Nikeli ka rëndësi për prodhimin e çelikut inox dhe për disa teknologji baterish.
Por Indonezia nuk dëshiron të kufizohet vetëm te shitja e mineralit të papërpunuar. Përmes politikave që synojnë zhvillimin e industrisë vendase, ajo ka kërkuar të tërheqë investime në përpunim dhe prodhim. Kjo strategji sjell mundësi ekonomike, por edhe debate. Kufizimet mbi eksportin e lëndëve të papërpunuara mund të nxisin përpunimin vendas, ndërsa njëkohësisht të krijojnë konflikte tregtare dhe kosto për partnerët ndërkombëtarë.

Për më tepër, ndërtimi i industrive të reja kërkon energji dhe mund të sjellë pasoja të konsiderueshme mjedisore. Megjithatë, shembulli indonezian tregon se gjeografia e pushtetit nuk është e pandryshueshme. Një vend që zotëron burime natyrore mund të përpiqet të ngjitet në zinxhirin e vlerës, në vend që të mbetet thjesht furnizues i lëndës së parë.
Kjo është një nga aspiratat më të rëndësishme të vendeve të pasura me minerale në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine.
Pyetja është nëse ato do të arrijnë të shndërrojnë pasurinë gjeologjike në kapacitet industrial dhe zhvillim afatgjatë.

Ana e errët e tranzicionit teknologjik

Ekziston një kontradiktë që nuk mund të lihet jashtë kësaj historie. Shumë prej mineraleve për të cilat po zhvillohet gara janë të nevojshme për teknologjitë që synojnë uljen e emetimeve të gazeve serrë.
Por nxjerrja dhe përpunimi i tyre mund të shkaktojnë dëme mjedisore, ndotje të ujërave, shkatërrim habitatesh dhe konflikte me komunitetet vendase.
Në disa rajone, problemet lidhen edhe me kushtet e punës, të drejtat e punëtorëve dhe transparencën e industrisë minerare.
Një makinë elektrike mund të ketë përfitime klimatike gjatë përdorimit dhe ciklit të jetës së saj, por kjo nuk e bën automatikisht të padëmshëm zinxhirin e furnizimit të materialeve që përdoren për prodhimin e saj.
Kjo është arsyeja pse gara për minerale kritike nuk mund të vlerësohet vetëm në terma strategjikë. Ajo ngre edhe një pyetje morale. Nëse vendet e pasura kërkojnë teknologji më të pastra, kush duhet të përballojë kostot e nxjerrjes së materialeve që i bëjnë të mundura ato?
Dhe si mund të sigurohet që vendet prodhuese të marrin përfitime të qëndrueshme ekonomike, në vend që të mbeten të ekspozuara ndaj ndotjes dhe luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare?
Në këtë kuptim, e ardhmja e mineraleve nuk është vetëm një çështje e rivalitetit mes superfuqive. Është edhe një provë për mënyrën se si ekonomia botërore e shpërndan pasurinë, rrezikun dhe përgjegjësinë.

Çfarë do të thotë kjo për Evropën dhe Ballkanin?

Për Bashkimin Evropian, varësia nga importet e lëndëve të para kritike është kthyer në një çështje të rëndësishme të politikës industriale. Evropa zotëron kapacitete të avancuara teknologjike dhe një treg të madh, por për shumë materiale strategjike varet nga furnizues jashtë kontinentit.
Kjo ka shtuar interesin për projekte minerare, përpunim, riciklim dhe marrëveshje me vende partnere. Në këtë kontekst, edhe Ballkani mund të fitojë rëndësi strategjike. Rajoni ka tradita minerare, rezerva të ndryshme metalesh dhe afërsi gjeografike me industrinë evropiane.
Por kjo nuk do të thotë se çdo projekt minerar është automatikisht një mundësi zhvillimi. Rëndësia ekonomike e një vendburimi varet nga cilësia e rezervave, kostot e nxjerrjes, infrastruktura, ndikimi mjedisor dhe mundësia për të krijuar industri përpunimi.
Për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit, pyetja nuk duhet të jetë thjesht sa minerale gjenden nën tokë. Pyetja më e rëndësishme është se çfarë vlere ekonomike dhe shoqërore mund të krijohet prej tyre.
Një vend mund të eksportojë lëndë të para për dekada pa ndërtuar një industri të zhvilluar. Mund të krijojë të ardhura afatshkurtra, por të mbetet i varur nga çmimet ndërkombëtare dhe vendimet e kompanive të huaja.
Nga ana tjetër, një politikë industriale e menduar mirë mund të lidhë burimet natyrore me përpunimin, arsimin profesional, teknologjinë dhe prodhimin vendas. Dallimi mes këtyre dy rrugëve nuk është vetëm ekonomik, por edhe politik. Sepse përcakton sa kontroll ka një vend mbi të ardhmen e tij.

Fuqia e vërtetë qëndron te zinxhiri

Në shekullin XX, një pjesë e madhe e gjeopolitikës mund të shpjegohej duke parë vendburimet e naftës dhe rrugët detare. Në shekullin XXI, duhet të shohim edhe minierat e litiumit, rafineritë e kobaltit, fabrikat e magnetëve, impiantet e përpunimit dhe portet përmes të cilave kalojnë materialet.
Por mbi të gjitha duhet të kuptojmë lidhjet mes tyre. Një vend mund të ketë mineralet, por jo teknologjinë për t'i përpunuar. Një tjetër mund të ketë fabrikat, por jo burimet natyrore. Një i tretë mund të ketë kapitalin, patentat dhe tregun përfundimtar. Asnjëri nuk është plotësisht i pavarur.
Prandaj gara për mineralet kritike nuk është vetëm një garë për pronësinë mbi burimet. Është një garë për të përcaktuar se kush kontrollon hallkat vendimtare të prodhimit dhe kush është në gjendje të vazhdojë të funksionojë edhe kur marrëdhëniet ndërkombëtare përkeqësohen.
Në këtë botë, ndikimi gjeopolitik nuk matet vetëm me territorin, madhësinë e ekonomisë apo fuqinë ushtarake. Ai matet edhe me aftësinë për të prodhuar gjërat pa të cilat ekonomitë e tjera nuk mund të funksionojnë. Dhe kjo mund të jetë një nga ndryshimet më të rëndësishme të epokës sonë.
Për shekuj, njerëzit kanë luftuar për tokën që mund të pushtonin. Sot, konkurrenca po përqendrohet gjithnjë e më shumë edhe te ajo që toka fsheh, te teknologjia që e nxjerr në sipërfaqe dhe te industria që e shndërron në fuqi. / Burimi: "The Shifting Dynamic of Critical Minerals Trade" | Bota.al

MINERALET QË PO RIFORMËSOJNË FUQINË BOTËRORE

Kobalti: Republika Demokratike e Kongos prodhon rreth 74% të kobaltit botëror të nxjerrë nga minierat.

Nikeli: Indonezia përbën rreth 67% të prodhimit global nga minierat.

Kina: Dominon përpunimin dhe rafinimin e shumë mineraleve kritike, përfshirë grafitin, galiumin dhe manganin.

Litiumi: Një nga materialet kryesore për bateritë e automjeteve elektrike dhe ruajtjen e energjisë.

Elementet e rralla: Neodimi, prazeodimi, disproziumi dhe terbiumi përdoren në magnetë të fuqishëm, motorë elektrikë dhe teknologji të avancuara.





sport



KOK-u do të marrë pjesë në takimin me ICMG-në në Athinë, në fokus ngecjet në organizimin e 'Prishtina 2030'

Prishtinë, 25 nëntor - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) do të marrë pjesë në një takim me Komitetin Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), i cili do të mbahet më 3 dhe 4 dhjetor në Athinë të Greqisë, ku në fokus do të jenë ngecjet në organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Lajmin e ka bërë me dije KOK-u për "Kosovapress", duke theksuar se ftesa për pjesëmarrje ka ardhur nga ICMG-ja. Pas përfundimit të takimit në Athinë, drejtuesit e KOK-ut do të raportojnë para Komitetit Organizativ të Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030" për diskutimet e zhvilluara dhe hapat e mëtejmë që pritet të ndërmerren.

Në qëndrimin e tij KOK-u ka theksuar se mbetet plotësisht i përkushtuar që Lojërat Mesdhetare të vitit 2030 të organizohen në Kosovë, por ka nënvizuar se suksesi i këtij projekti varet nga përkushtimi i të gjitha institucioneve të përfshira. Takimi i 3 dhe 4 dhjetorit në Athinë vjen në një periudhë kur organizimi i "Prishtina 2030" po përballet me sfida dhe vonesa në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara për këtë ngjarje të madhe sportive.



DELEGACIONI I UEFA-S NË KOSOVË, ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË FUTBOLLIT NË FOKUS TË VIZITËS

Prishtinë, 25 nëntor - Anëtari i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s dhe kryetari i Komitetit për Stadiume dhe Siguri, Petr Fousek, si dhe drejtori i Programit HatTrick dhe i Zhvillimit të Federatave Kombëtare në UEFA, Thierry Favre, kanë qëndruar për një vizitë dyditore në Kosovë, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet UEFA-s dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.

Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i UEFA-s, i shoqëruar nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi, është pritur në takim nga ministri i Sportit, Blerim Gashani, ku në fokus të diskutimeve kanë qenë zhvillimi i infrastrukturës së futbollit, investimet strategjike dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për avancimin e mëtejshëm të futbollit të Kosovës.

Ministri Gashani e ka falënderuar UEFA-n për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës, duke e cilësuar rrugëtimin dhjetëvjeçar të futbollit të Kosovës në familjen evropiane të futbollit si të jashtëzakonshëm dhe shumë produktiv. Ai e ka vlerësuar punën e FFK-së nën drejtimin e presidentit Agim Ademi, duke shprehur optimizëm për të ardhmen e futbollit në vend. Gashani ka thënë se, krahas vazhdimit të punimeve në stadiumet ku aktualisht po punohet, shumë shpejt do të dëgjohet lajmi për fillimin e ndërtimit të stadiumit nacional.

Ndërsa Petr Fousek ka theksuar se qëllimi i kësaj vizite është ta rikonfirmojë mbështetjen e UEFA-s për Federatën e Futbollit të Kosovës dhe ta vlerësojë punën e vazhdueshme zhvillimore që po bëhet nën udhëheqjen e presidentit Ademi. Ai ka nënvizuar besimin e UEFA-s në punën dhe vizionin zhvillimor të FFK-së, duke theksuar njëkohësisht rëndësinë e mbështetjes së institucioneve shtetërore, veçanërisht në realizimin e projekteve infrastrukturore, si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të futbollit.

Në anën tjetër, Thierry Favre ka thënë se rikthimi në Kosovë ka gjithmonë një domethënie të veçantë për të, duke qenë pjesë e rrugëtimit të futbollit kosovar në UEFA që nga dita e parë. Ai e ka vlerësuar progresin e arritur ndër vite, duke veçuar Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali si një nga projektet më të mëdha dhe më të rëndësishme zhvillimore në Kosovë.



Pas takimit me ministrin Gashani, delegacioni i UEFA-s, i shoqëruar nga presidenti Ademi, ka vizituar Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, ku është njohur nga afër me investimet e realizuara, kapacitetet infrastrukturore dhe planet për zhvillimin e mëtejshëm të këtij kompleksi. Kampi Nacional përbën një nga investimet më strategjike të FFK-së, me rëndësi të veçantë për përgatitjen e ekipeve kombëtare, zhvillimin e talenteve të reja dhe ngritjen e standardeve profesionale të futbollit në vend.

Në kuadër të qëndrimit të tyre në Kosovë, përfaqësuesit e lartë të UEFA-s kanë vizituar edhe stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ku janë njoftuar nga afër me gjendjen aktuale të infrastrukturës, kushtet dhe kapacitetet e stadiumit që mirëpret ndeshjet ndërkombëtare të Kombëtares së Kosovës dhe klubeve në garat evropiane.

Ndërkohë, vizitën e tyre e kanë përmbyllur me një takim me kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Në fokus të diskutimeve ka qenë ndërtimi i stadiumit të ri në kryeqytet, i cili është vlerësuar si domosdoshmëri për zhvillimin e mëtejshëm të futbollit dhe avancimin e infrastrukturës sportive në vend.

Gjatë takimit është diskutuar edhe për potencialin e Prishtinës që, në një të ardhme të afërt, të jetë mikpritëse e ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare të futbollit, përfshirë edhe finalet e garave të UEFA-s. Në këtë drejtim, ndërtimi i një stadiumi modern, që përmbush standardet më të larta të UEFA-s, do të krijonte mundësi të reja për pozicionimin e kryeqytetit dhe të Kosovës në hartën e organizimeve të rëndësishme të futbollit evropian. Palët kanë theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet FFK-së, komunës së Prishtinës dhe UEFA-s për realizimin e këtij projekti strategjik.

CAS-I ZYRTARIZON SENEGALIN KAMPION TË AFRIKËS



Lozanë, 25 nëntor - Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS) ka vendosur që Senegali të jetë kampion i Kupës së Afrikës, si fitues në fushë, duke anuluar rezultatin zyrtar që i ishte dhënë Marokut në tavolinë. Vendimi i CAS-it vlerësohet si një ditë historike për futbollin, pasi ka hedhur poshtë vendimin e Konfederatës Afrikane të Futbollit.

CAS-i ka treguar, pas më shumë se 300 ditësh, se kush meriton të shpallet kampion i Afrikës, pas finales që u zhvillua në janar të këtij viti në Rabat të Marokut.

Senegali kishte fituar 1:0 në fushë pas vazhdimeve, por fillimisht e kishte braktisur fushën për 15 minuta, pasi ishte akorduar penallti për Marokun. Penalltia e Marokut u prit, ndërsa Senegali fitoi në vazhdime. Megjithatë, Konfederata Afrikane e Futbollit vendosi që Maroku të shpallej kampion i Afrikës, pas ankesës që kishte bërë. Megjithatë, Senegali ka reaguar duke e dërguar çështjen në CAS, ku tashmë e ka fituar të drejtën e tij.

Ronaldo gjithnjë e më afër shifrës së 1 000 golave

Prishtinë, 25 nëntor - Ylli portugez Cristiano Ronaldo gjithnjë e më shumë po i afrohet shifrës jubilare prej një mijë golash në karrierë. Ronaldo ka shënuar golin e 987-të në karrierë, ndërsa ekipi i tij, Al Nassr, ka triumfuar 2:1 ndaj Al Saddit në Ligën e Kampionëve të Azisë. Me golin e realizuar në këtë përballje, Ronaldos tani i duhen edhe vetëm 13 gola për të arritur shifrën prej një mijë golash të shënuar në karrierë. Portugezi ka realizuar në minutën e 13 nga penalltia, duke e kaluar ekipin e tij në epërsi 1:0 në ndeshjen e Ligës së Kampionëve të Azisë.

41-vjeçari pritet të largohet nga futbolli aktiv në fund të këtij sezoni, kur i skadon edhe kontrata me skuadrën saudite, ndërsa synimi i tij është që të pensionohet me një mijë gola të shënuar. Ai është transferuar tek Al Nassr në fillim të vitit 2023, ndërsa karrierë në Evropë ka bërë edhe te Manchester Unitedi, Juventusi dhe Real Madridi.







NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "CFC Menxhiqi " SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 812408682 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "CFC Menxhiqi" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 812408682 ujedno imenovao Likvidatora o spravodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "CFC Menxhiqi" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business NUI: 812408682 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES